



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2024

Lënda: Kthim përgjigje

E nderuar,

Në vijim të shkresës Tuaj datë 16.01.2024, të administruar në Bashkinë Shkodër me nr. prot 3616, datë 21.02.2024 Ju informojmë si më poshtë vijon:

1. *A kanë përfituar OJF-të fonde publike nga institucioni juaj gjatë vitit 2023? Nëse po, cila ka qenë forma e përfitimit të këtyre fondeve grant, kontratë, prokurim publik/tenderim, etj.*

Gjatë vitit 2023 OJF-të kanë përfituar mbështetje financiare nga Bashkia Shkodër. Format e dhënies së granteve janë të ndryshme dhe për rrjedhojë procedurat e ndjekura nga Bashkia Shkodër janë disa, përmendim këtu marrëveshjet e bashkëpunimit dy palëshe, prokurimin me vlerë të vogël, thirrje e hapur për projekt propozime dedikuar OJF-ve sipas metodologjisë LOD të programit ReLOaD/sport (miratuar me VKB nr. 69, datë 30.10.2017 ‘‘Për miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara, Bashkisë Shkodër dhe Metodologjisë LOD’’; VKB nr. 18 datë 25.03.2021 ‘‘Për vazhdimin e financimit të disiplinave sportive sipas PBA 2021-2023), thirrje e hapur për projekt propozime me Këshillin artistik - kulturor, përjashtimin nga detyrimet tarifore, transfertë specifike në fushën e shërbimeve sociale dhe zhvillimit ekonomik dhe turizmit.

2. *Sa OJF kanë aplikuar për fonde publike pranë institucionit tuaj gjatë vitit 2023? Ju lutem specifikoni sipas formës, nëse ka patur më shumë së një formë.*

- Për aktivitetet sportive kanë përfituar mbështetje financiare 15 OJF sportive, sipas metodologjisë LOD të programit ReLOaD/sport.
- Për aktivitetet artistike – kulturore kanë përfituar mbështetje financiare 4 OJF, sipas procedurës për projekt propozime me Këshillin artistik kulturor.
- Për shërbimet sociale kanë përfituar mbështetje financiare 3 organizata.
- Në fushën e zhvillimit ekonomik dhe turizmit ka përfituar mbështetje financiare shoqata BID Shkodër.

3. *Sa OJF kanë përfituar nga këto fonde? Ju lutem bashkëngjisni listën e fituesve sëbashku me buxhetet përkatëse. Specifikoni sipas formës nëse ka patur më shumë së një formë.*

Nr	Përfituesi - OSHC-ja që ka zbatuar aktivitetin/fondin	Fondi (lekë)
Procedura: Metodologjia LOD e Programit Reload/Sport		
1	Shoqata Atletikë Vllaznia	3,380,000
2	Shoqata Sportive e Boksit "Shkodra Boks"	3,075,512
3	Shoqata Sportive e Ping Pongut Vllaznia	426,800
4	Shoqata Sportive Judo Vllaznia	1,434,000
5	Shoqata Shkodra Not	303,000
6	Klubi i çiklizmit Shkodra	1,299,000
7	Shoqata e gjimnastikës	519,000
8	Qendra 'Lulebora'	323,000
9	Shoqata sportive e basketbollit Vllaznia	7,066,000
10	Shoqata Volej Vllaznia	4,488,000
11	Shoqatës së Futbollit të Femrave Vllaznia	1,493,000
12	Shoqata Future Sports Academy Shkodër 2022	674,000
13	Shoqata "Veriu i Shkodrës 2021"	522,000
14	Shoqata Sportive "Vllaznia-Mundje"	515,000
15	Shoqata e Shkodrës Vllaznia Volleyball	3,507,000
Procedura: Marrëveshje bashkëpunimi		
16	BID Shkodra	1,600,000
Procedura: Këshill artistik kulturor		
17	Shoqata Kulturore "Prenkë Jakova"	1,800,000
18	Shoqata Kulturore Rrok Jakaj	3,000,000
19	Qendra Za	800,000
20	Fondacioni Arte	500,000
Procedura: Transfertë e pakushtëzuar sektoriale		
21	Projekti "Shpresa"	16,891,000
22	Madonnina della Grappa	20,342,000
Procedura: Honorare për instruktorët dhe punonjësit social të trupës muzikore Transport për trupën muzikore		
23	The Door Albania	369 000

4. Keni ofruar mbështetje jo financiare për OJF-të gjatë vitit 2023? Nëse po, ju lutem specifikoni bazën ligjore/rregullore që rregullon këtë formë mbështetje.

Bashkia Shkodër ka një bashkëpunim të vazhdueshëm me organizatat e shoqërisë civile në fusha të ndryshme si shërbime sociale, zhvillim ekonomik, turizm, kulturë, sport etj. Baza ligjore në të cilën mbështetet ky bashkëpunim është Kodi Civil ligji nr.7850, datë 29.07.1994, i ndryshuar; Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; Ligji nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", i ndryshuar; Ligji nr. 10296 dt. 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i

ndryshuar; Ligji nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; Ligji nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; Ligji Nr. 45/2016 Për vullnetarizmin; VKM nr. 822 datë, 06/12/2006 “Për miratimin e standarteve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuara, në qendrat rezidenciale dhe ditore”. VKB nr. 69, datë 30.10.2017 “Për miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara, Bashkisë Shkodër dhe Metodologjisë LOD”; VKB nr. 18 datë 25.03.2021 “Për vazhdimin e financimit të disiplinave sportive sipas PBA 2021-2023, programi ‘Sport dhe Argëtim’, përmes metodologjisë LOD, pas mbylljes së funksionimit të klubit sportiv ‘Vllaznia’ ”. VKB nr. 71 datë 27.12.2022 “Për buxhetin e vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Shkodër”; VKB nr. 1, datë 22.1.2016 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër, i ndryshuar, pjesa II, pika 4.10. Udhëzimi nr. 689 datë 02.10.2018 “Për nivelin e Kuotave të shpenzimeve për ushqime në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror”; *Si dhe një sërë ligjesh të tjera në varësi të fushës së bashkëpunimit.*

5. *Nëse keni ofruar mbështetje jo-financiare gjatë vitit, sa OJF kanë përfituar nga kjo mbështetje? Cili ka qënë lloji i mbështetjes jo-financiare të ofruar mjedise, trajnime, ndarje eksperiencash, etj.*

Në fushën e shërbimeve sociale ka pasur një sërë bashkëpunimesh gjatë të cilave OJF të ndryshme kanë përfituar mbështetje jo-financiare (mjedise, trajnime). Njëkohësisht është ofruar mbështetje për përjashtimin nga detyrimet tarifore për përdorimin e hapsirës publike në rastet e aktiviteteve të zhvilluara sipas marrëveshjeve respective të bashkëpunimit.

Me respekt,

KRYETAR

Benet Beci